



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Perandori Justinian p.n., Prishtinë/a, Kosovë/o
T: +381 (0)38 220 104/5; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, 27 korrik 2010

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121, dhe të nenit 16 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sekretaria ri-shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

1. Zyrtar ligjor për hulumtime (2)

1.

Pozita: Zyrtar Ligjor për Hulumtime Ligjore
Kodi: SP –DPP A 02-03
Numri i Pozitave: 2 (dy)
Kohëzgjatja e kontratës: Tre (3) vjet me mundësi vazhdimi
Puna Provuese: Tre (3) muaj

Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozitës: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Zyrës dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të Këshilltarëve Ligjor mbështet punën profesionale të gjyqtarëve dhe Këshilltarëve Ligjor të Gjykatës Kushtetuese duke bërë hulumtime dhe analiza lidhur me aspekte të ndryshme ligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kryen hulumtime ligjore lidhur me legjislacionin e aplikueshëm si dhe instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë;
- Analizon çështje të ndryshme ligjor sipas kërkesave të Drejtorit të Departamentit për Përkrahje Profesionale si dhe Këshilltarit të Parë Ligjor, Këshilltarëve Ligjor dhe gjyqtarëve përkatës;
- Ndihmon Këshilltarin e Parë Ligjor, Këshilltarët Ligjor dhe gjyqtarët përkatës në kryerjen e punës së tyre;
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Këshilltarit të Parë Ligjor, Këshilltarëve Ligjor dhe gjyqtarëve përkatës.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, duke preferuar njohuri të specializuar në të drejtën kushtetuese, të drejtën publike apo të drejtën publike ndërkombëtare;
- Së paku tri (3) vjet të përvojës përkatëse profesionale në çështjet juridike;

Kandidati për pozitën e Zyrtares për hulumtime ligjore duhet të posedojë njohuri të thella profesionale si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese, analitike dhe organizative. Të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht programeve MS Word, Excel dhe internetit, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës shqipe dhe serbe dhe angleze në të folur dhe shkruar.

Informata të Përgjithshme për Kandidatë

Përcaktimi i pagës, për të gjitha pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e Punës dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me klasifikimin e pozitave, pagave, shtesave dhe mëditjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimit dhe mirëpret aplikacionet nga personat e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe të të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procesit të punësimit në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale dhe një letër motivuese. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb faqja e Gjykatës Kushtetuese www.gjk-ks.org
Aplikacioni me të gjitha dokumentet duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit në adresën resmije.losi@ks-gov.net.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **12 gusht 2010, në orën 24:00.**

Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të merren në konsiderim.

Njëkohësisht, njoftohen të gjithë kandidatët, të cilët kanë aplikuar në konkursin e mëparshëm, të publikuar më datën 15 qershor 2010 dhe 06 korrik 2010 në të përditshmet: Koha Ditore, Zëri dhe Bota Sot, të emituar në Radio Graçanica, si dhe të publikuar në faqen ueb të Gjykatës Kushtetuese, se aplikacionet e tyre do të merren parasysh dhe se nuk kane nevojë për aplikim të sërishëm.